



*VENDIM*

*Nr. 141, Datë 15.08.2016*

**MBI LICENSIMIN E SHOQËRISË “PRELL ENERGY” SH.P.K NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HEC “PRELLË” ME FUQI TË INSTALUAR 14970 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe nenit 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transerimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike“, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.08.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Prell Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se :**

Aplikimi i shoqërisë “Prell Energy” sh.p.k., plotëson tërërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.1.4 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe 4.1.5 gërmat “a”, “b”, “c”; është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “Prell Energy” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Prellë” me fuqi të instaluar 14970 KW, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.